



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202300066/4

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme administrative për nxjerrjen e vendimit për konstatimin e parashkrimit të dënimit administrativ të vendosur ndaj shtetasit A.K. me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes datë 03.01.2021.*

DREJTORISË VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Tiranë

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTIT PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Tiranë

Z. A.K.
"Kodra e Diellit", Rr. "Reshit Bali", Selitë

Tiranë

Me shkresën nr. K2/A3-2 prot., datë 31.01.2023, ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit në datën 24.01.2023 ka paraqitur ankesë shtetasi A.K., i datëlindjes 12.10.1976, lindur në Burrel dhe banues në Londër, Angli, me shtetësi angleze, i pajisur me pasaportën angleze me nr. 124083611. Ankuesi shkruan se është gjobitur nga Komisariati i Policisë Kufitare Rinas me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes administrative nr. 0000892, datë 03.01.2021, në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, por gjobën nuk e ka paguar.

Sipas ankuesit, në zbatim të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 46, ku parashikohet se: “... gjoba e cila nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve, parashkruhet...”, në datën 04.01.2023, ai i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë për fshirjen e gjobës në sistemin TIMS. Ankuesi pretendon se, ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes ka kaluar, ajo nuk i është kthyer ende dhe se gjoba nuk është fshirë nga sistemi.

Gjithashtu ankuesi shkruan se nga punonjës të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë verbalisht i është thënë se gjoba për shtetasit e huaj nuk parashkruhet dhe nuk hiqet nga sistemi TIMS. Sipas tij, ky qëndrim përveç faktit që është në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, cënon edhe të drejtën e barazisë së shtetasve të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në vijim të ankesës së bërë, ankuesi kërkon ndërhyrjen e institucionit tonë për të bërë të mundur fshirjen nga sistemi TIMS i gjobës së vendosur atij në datën 03.01.2021 dhe ndëshkimin e punonjësve të kësaj drejtorie.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*” dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma “b” të ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”, ju kërkuam të na dërgonit një informacion lidhur me këtë ankesë dhe pretendimet e ankuesit të parashtruara më sipër.

Ju me shkresën nr. 167/1 prot., datë 06.02.2023, na informuat se në datën 03.01.2021, në orën 15:50, shtetasi A.A.K., i pajisur me pasaportë të Britanisë së Madhe është paraqitur tek Roja Kufitare në PKK Rinas për të kryer procedurat e daljes nga Republika e Shqipërisë me destinacion Britaninë e Madhe.

Roja Kufitare, në zbatim të Aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, të ndryshuar, nenit 3/4/b, me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes administrative me nr. serie 0000892, datë 03.01.2021, e ka ndëshkuar këtë shtetas me masën administrative, gjobë në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për shkak se ka shkelur karantinimin e detyruar prej 14 ditësh.

Në vijim të kësaj përgjigjeje na informuat se, kërkesa e këtij shtetasi për fshirjen e gjobës nga sistemi TIMS për shkak të parashkrimit, është kaluar për trajtim dhe vlerësim në komisionin për shqyrtimin e kërkesë-ankesave për masat administrative, i krijuar me

Urdhrin nr. 142/b, datë 10.03.2022, të Drejtorit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë.

Komisioni me vendimin nr. 01, datë 18.01.2023 ka vendosur:

“Moskompetencën e tij për shqyrtimin e kërkesës së shtetasit A.A.K., për shkak se trajtimi i masës administrative, gjoba me nr. serie 0000892, datë 03.01.2021, vendosur në PKK Rinas, në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, bëhet në zbatim të Urdhrit nr. 349, datë 17.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për procedurat e konstatimit, evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar Covid-19”.

Gjithashtu ju na informuat se, me shkresën nr. 04/01, datë 18.01.2023, i është kthyer përgjigje shtetasit A.K. në adresën e e-mailit të tij.

Me shkresën nr. A-9/3, datë 30.01.2023, me lëndë: “Dërgojmë për ndjekje ankesën me nr. A-9/2, datë 27.01.2023, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin i është drejtuar Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, ku kërkohet që të vepohet sipas “interpretimit juridik” të Drejtorisë Juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, referuar ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenit 46 “Parashkrimi administrativ”.

Pas dërgimit të kësaj shkrese, ju me shkresën nr. 142/1 prot., datë 01.02.2023, i keni kthyer përgjigje Departamentit për Kufirin dhe Migracionin duke këmbënguluar në faktin se nuk jeni ju organi kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë, por ajo duhet të shqyrtohet në zbatim të Urdhrit nr. 349, datë 17.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për procedurat e konstatimit, evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar Covid-19”, pika II, me titull “Evidentimi dhe shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative”. Sipas jush, kjo pikë përcakton qartë të drejtën e konstatimit, evidentimit, shkeljet e parashikuara, plotësimin e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes administrative, radhën e punës së Shefit të Seksionit të Rendit/Policimit në Komunitet për evidentimin e tij, gjobës në regjistrin përkatës dhe regjistrin elektronik dhe përgatit praktikën për shqyrtimin e kundërvajtjes nga Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative....”

Përveç sa më sipër, në këtë përgjigje na informuat se nga organi juaj janë zbatuar të gjitha aktet ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e shërbimit të Policisë Kufitare.

Së bashku me përgjigjen ju na dërguat edhe kopje të dokumenteve të përpiluara lidhur me këtë rast, si Procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes i datës 03.01.2021; Kërkesa e shtetasit A.K. drejtuar Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë e datës 04.01.2023; Vendimi nr. 01, datë 18.01.2023, i komisionit për shqyrtimin e kërkesës-

ankesave për masat administrative, i krijuar me Urdhrin nr. 142/b, datë 10.03.2022, të Drejtorit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë; Kthim përgjigje shtetasit A.K. me nr. K-04/1 prot., datë 18.01.2023; Shkresa me nr. 142/1 prot., datë 01.02.2023 e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë drejtuar Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, të përgjigjes së dërguar nga organi juaj dhe dokumentacionit bashkëlidhur asaj, konstatojmë se:

1. Gjoha e vendosur shtetasit A.K. me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes në datën 03.01.2021 është e bazuar në ligj dhe e drejtë. Kjo gjobë është vendosur nga punonjësi i Policisë Kufitare Inspektor Përparim Koxha me detyrë Roje Kufitare në emër të organit që ju përfaqësoni, Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, në zbatim të Aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, të ndryshuar, respektivisht nenit 3/4/b, për shkak se ai ka shkelur detyrimin për t’u karantinuar për një periudhë 14 - ditore.

2. Vendimi nr. 01, datë 18.01.2023, i marrë nga komisioni për shqyrtimin e kërkesë-ankesave për masat administrative, i krijuar me Urdhrin nr. 142/b, datë 10.03.2022, të Drejtorit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë lidhur me kërkesën e shtetasit A.A.K, duke vendosur: *“Moskompetencën e tij për shqyrtimin e kërkesës së shtetasit Altin Adem Koka, për shkak se trajtimi i masës administrative, gjoha me nr. serie 0000892, datë 03.01.2021, vendosur në PKK Rinas, në masën 700 000 (shtatëqindë mijë) lekë, bëhet në zbatim të Urdhrit nr. 349, datë 17.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për procedurat e konstatimit, evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar Covid-19”, është i pabazuar në ligj dhe si rrjedhojë i padrejtë.*

Në vlerësimin tonë, ky qëndrim është rezultat i moskuptimit të thelbit të kërkesës së paraqitur nga shtetasi A.K.. Ky shtetas në kërkesën drejtuar Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë nuk kundërshton si të padrejtë dënimin administrativ apo masën e gjobës, e cila i është vendosur atij në datën 03.01.2021, por ai kërkon fshirjen e gjobës në sistemin TIMS, për arsye se kjo masë është parashkuar.

Po ashtu, edhe në ankesën e paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit ai nuk kërkon shfuqizimin e kësaj gjobe si të padrejtë.

Nëse do të ndodheshim në rrethanat që ankuesi do të ankohej ndaj dënimit administrativ apo masës së gjobës të vendosur atij nga Roja Kufitare në PKK Rinas me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes me nr. serie 0000892, datë 03.01.2021, pavarësisht faktit se ka kaluar afati brenda të cilit mund të ushtrohej e drejta e ankimit, atëhere vlerësimi i komisionit të ngritur pranë organit tuaj, për shpalljen e moskompetencës së tij dhe dërgimin e saj për shqyrtim në organin epror në zbatim të Urdhrit nr. 349, datë

17.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për procedurat e konstatimit, evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar Covid-19”, mund të legjitimohej.

Gjithashtu ne vlerësojmë se qëndrimi i gabuar i komisionit në vendimin e dhënë ka ardhur edhe si pasojë e mosvlerësimit të drejtë të institutit juridik të parashkrimit. Ju sjellim në vëmendje se në nenin 46 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” parashikohet “Parashkrimi i dënimit administrativ”. Në këtë nen parashikohet se:

“Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe, dënimi administrativ, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet. Në këtë rast, organi administrativ, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Në vendimin, ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrativ, listohen edhe arsyet që kanë çuar në këtë përfundim”.

Sipas “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, **“parashkr/úaj folje kalimtare; -óva, -úar term në drejtësi; nuk ia njoh më një të drejtë a një detyrim dikujt ose ia quaj të shlyer një dënim, pasi ka kaluar koha e parashikuar nga ligji”.**

Pra, nga referimi në nenin e cituar më sipër dhe në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, kuptohet në mënyrë të qartë dhe pa asnjë ekuivok se me kalimin e afatit të parashikuar në ligj, i cili është dy vjet nga data e marrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, dënimi administrativ shuhet dhe nuk mund të ekzekutohet. Në rastin që po trajtojmë provohet fakti se kanë kaluar me shumë se dy vite nga marrja e vendimit për dënimin administrativ të dhënë ndaj shtetasit A.K. në datën 03.01.2021. Ndërkohë për të qenë korrekt me përmbajtjen e nenit 46 sqarojmë se, ligji i posaçëm “Akti normativ nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës së zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19””, i ndryshuar, në bazë të të cilit është vendosur kjo masë administrative, nuk parashikon një qëndrim të ndryshëm nga neni 46 i ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Pra, ai nuk parashikon mos parashkrimin e dënimit administrativ.

3. Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesës së shtetasit A.K. dhe marrjen e vendimit për konstatimin e parashkrimit të dënimit administrativ të tij, të dhënë në datën 03.01.2021 në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, është Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, sepse ky organ *ka nxjerrë apo marrë vendimin/procesverbalin për konstatimin e kundërvajtjes dhe dënimin administrativ të këtij shtetasi*. Ky konstatim provohet edhe nga referimi i bërë në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes të datës 03.01.2021, përpiluar nga Inspektor Përparim Koxha, ku rezulton se ai ka vepruar në emër të këtij organi.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, ne çmojmë se për shkak të vlerësimit dhe qëndrimit jo në përputhje me ligjin të organit tuaj, shtetasit A.K. i është cenuar një e drejtë e garantuar nga ligji, respektivisht neni 46 i ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ajo e parashkrimit të dënimit administrativ të dhënë atij në datën 03.01.2021.

Ju sjellim në vëmendje se referuar nenit 16, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *“Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara...”*

Theksojmë se shkelje të tilla të të drejtave ligjore të shtetasve nuk cenojné vetëm individët, por në të njëjtën kohë ato dëmtojnë edhe imazhin dhe reputacionin e Policisë së Shtetit në publik.

Qëndrimi i mbajtur në këtë rast nga strukturat e organit tuaj, është në kundërshtim të plotë dhe të hapur me qëllimin e Kodit të Procedurave Administrative dhe parimet e ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, si dhe atë të përgjegjësisë të parashikuara në nenet 1, 4, 13, 14, 15, të Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë¹, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga punonjësit e administratës publike.

Gjithashtu ju sjellim në vëmendje se referuar nenit 41/1 të Kodit të Procedurave Administrative “Fillimi i procedurës administrative”, konstatimi i parashkrimit të dënimit

¹ Neni 1 “Qëllimi i ligjit” parashikon se:

“Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor”.

Neni 4 “Parimi i ligjshmërisë” parashikon se:

“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”.

Neni 13 “Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë” parashikon se:

“Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie”.

Neni 14 “Parimi i objektivitetit” parashikon se:

“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”.

Neni 15 “Parimi i përgjegjësisë” parashikon se:

“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejné një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës”.

administrativ mund të bëhet jo vetëm mbi bazën e kërkesës së shtetasve të dënuar administrativisht, por edhe edhe me nismën e vet organit administrativ kompetent që ka dhënë masën administrative.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi të shpejtë, objektiv dhe profesional nga strukturat e organit tuaj, duke analizuar shkaqet, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe mos përsëritjen e tyre në të ardhmen me qëllim për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga organi juaj për nxjerrjen e vendimit për konstatimin e parashkrimit të dënimit administrativ të dhënë ndaj shtetasit A.K.me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes në datën 03.01.2021 në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, i përpiluar nga Inspektor Përparim Koxha, me detyrë Roje Kufitare në Komisarriatin e Policisë Rinas dhe fshirjen e saj nga sistemi TIMS.
2. Marrjen e masave të nevojshme për të analizuar në mënyrë të thellë, me objektivitet dhe me profesionalizëm të shkaqeve të mos veprimit konform ligjit për konstatimin e parashkrimit të dënimit administrativ të ankuesit A.K..
3. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin në vijimësi të punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe njohjen e akteve normative që garantojnë respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve.
4. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit në Tiranë dhe në shkallë vendi me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të shtetasve nga punonjësit e policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi